

VENDIM
Nr. 482, datë 13.7.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE, DHE *ARTIGIANCASSA S.P.A.*, PËR FINANCIMIN E
PROGRAMIT TË NDIHMËS SË INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN E
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME SHQIPTARE, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 147/2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe *Artigiancassa S.P.A.*, për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, ratifikuar me ligjin nr. 147/2013, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Shkëlqesisë së Saj, znj. Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Qeveria e Republikës së Shqipërisë

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj
Drejtoria e Koordinimit dhe Ofrimit të Ndihmës së Huaj Sektori i Marrëveshjeve dhe Ofrimit të Ndihmës së Huaj
Dëshmorët e Kombit nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Për dijeni: Me postë elektronike të regjistruar
Ministrisë Italiane për Punët e Jashtme, Zyra V DGCS
Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor

Romë, 17.3.2022

Lënda: Marrëveshje Financiare F.ROT 11/006/00, me vlerë 15,000,000.00 euro ndërmjet Këshillit të Ministrave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe *Artigiancassa S.P.A.* (të zëvendësuar nga *Cassa Depositi e Prestiti S.P.A.*) – Program në favor të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri

Duke iu referuar shkresës suaj me numër protokolli **421, datë 12.1.2022.**

E nderuar Zonjë,

Duke iu referuar Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur dhe në vijim të kërkesës suaj të datës 12.1.2022, ju informojmë se:

- periudha e disbursimit të kredisë së butë do të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2022, pa cenuar sekuestrimin e fondeve që pritet të disbursohen deri në dhënien e vendimit nga ana e gjykatësit;

- pas marrjes së raportit, siç parashikohet në nenin 9.6, nga Ministria juaj e nderuar që vërteton përdorimin e fondeve të disbursuara, duke filluar nga dita e sotme, do të adresojmë dhe do t'ju komunikojmë shtyrjen e periudhës së disbursimit për asistencë teknike deri në datën 31 tetor 2022.

Me respekt,

(nënshkrimi)

Lisbi C. Valdez

Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.

Kreu i Fondit të Disponueshëm për Bashkëpunim Zhvillimor

Cassa Depositi e Prestiti Societa per Azioni Via Goito, 4 -00185 Roma T +39 06 4221 1 F +39 06 4221 4026	Capitale Sociale € 4.051.143.264,00 i.v. Iscritta presso CCIAA di Roma al n.REA 1053767	Codice Fiscale e iscrizione al Registro delle Imprese di Roma 80199230584 Partita IVA 07756511007
--	---	---

00185 – Romë, Itali

Bashkëpunimi Ndërkombëtar: fondorotativocs@cdp.it

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Drejtoria e Huamarrjes, Divizioni i Marrëveshjeve Departamenti i Përgjithshëm i Borxhit Publik

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

TIRANË, SHQIPËRI

k.a. z. Gavril Lasku – Drejtor

Për dëjnen të:

MINISTRISË ITALIANE PËR PUNËT E JASHTME DHE ZYRËS V DGCS PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

AGJENCISË ITALIANE PËR BASHKËPUNIM ZHVILLIMOR – ROMË

AGJENCISË ITALIANE PËR BASHKËPUNIM ZHVILLIMOR – TIRANË

Romë, 16.5.2022

Lënda: **Marrëveshje Financiare me një vlerë prej 15,000,000.00 eurosh ndërmjet Artigiancassa S.p.A. dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë F.ROT/AID 11/006/00**

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar shkresës suaj me nr. prot. 25, të datës 18.3.2022, nëpërmjet këtij dokumenti dëshirojmë t'ju informojmë se pas marrjes së raporteve të auditimit dhe rishikimit të përbashkët të kryer nga AICS-ja në Romë dhe CDP-ja, duke marrë parasysh ngjarjet e ndryshme që kanë ndikuar në përdorimin e fondeve të disbursuara, nuk ka asnjë kundërshtim për zgjatjen e afatit të

përdorimit të fondeve tashmë të disbursuara deri në datën 31 mars 2023 për kuotën e kredisë koncesionare, që synon financimin e linjës së kredisë për NVM-të dhe asistencën teknike.

Cassa Depositi e Prestiti Societa per Azioni Via Goito, 4 -00185 Roma T +39 06 4221 1 F +39 06 4221 4026 00185 – Romë, Itali	Capitale Sociale € 4.051.143.264,00 i.v. Iscritta presso CCIAA di Roma al n.REA 1053767	Codice Fiscale e iscrizione al Registro delle Imprese di Roma 80199230584 Partita IVA 07756511007
---	---	---

Në pritje të marrjes së raportit të përditësuar të auditimit: i. kur të përdoren në mënyrë të plotë fondet; ose ii. kur të skadojë afati i lartpërmendur.

Me respekt, nënshkruar elektronikisht nga Lisbi Valdez

Datë 16.5.2022, 14:52:02

Lisbi C. Valdez
Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.
Fondi i Disponueshëm për Bashkëpunim Zhvillimor